STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 24 nëntor 2012

GUVERATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE LIRR RIVENDOS SHERBIMIN E FUNDJAVES TE TRENIT ELEKTRIK NE DEGEN E LONG BIÇ (LONG BEACH) TE DIELEN 25 NENTOR; SHERBIMI ELEKTRIK I DITEVE TE JAVES DO TE RIVENDOSET TE HENEN, 26 NENTOR

Të bashkëngjitura anullimet dhe devijimet e hollësishme të pikut të mëngjesit dhe pasdites

Vazhdojne riparimet e Amtrak-ut në tunelet e Lumit Lindor, duke rezultuar në kapacitet të pakësuar të vazhdueshëm të Tunelit të Lumit Lindor

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Hekurudha e Long Ajlënd (Long Island) (LIRR) e MTA-së është duke rivendosur shërbimin e trenit elektrik në Degën e Long Biç (Long Beach) duke filluar të dielën 25 nëntor. Në rivendosjen e shërbimit elektrik të Long Biç (Long Beach), LIRR do të funksionojë me një grafik pothuajse normal në të gjitha 11 degët e saj për herë të parë që kur Super Stuhia Sendi (Sandy) goditi rajonin.

LIRR do të funksionojë me një grafik të rregullt gjatë fundjavës në Degën e Long Biç (Long Beach) të dielën me katër trena shtesë të tjerë për festat të planifikuar drejt lindjes dhe katër trena shtesë drejt perëndimit. Treni i parë drejt Long Biç (Long Beach) do të niset nga Xhamejka (Jamaica) në 1:32 në mëngjes. Treni i parë që vjen nga Long Biç (Long Beach) do të jetë në 3:53 të mëngjesit të dielën.

Të hënën, LIRR do të përdorë shërbimin e trenit elektrik në degën e Long Biç (Long Beach), por katër trena do të anullohen në pikun e mëngjesit dhe katër do të anullohen në pikun e pasdites si rezultat i kapacitetit të pakësuar të pikut në dy tunelet e Lumit Lindor të Amtrak-ut që u përmbytën gjatë stuhisë. Amtraku vazhdon punën e tij në riparimin e sistemit të sinjaleve të dëmtuar rëndë në dy tunelet e tyre gjatë Super Stuhisë Sendi (Sandy). Një sistem i përkohëshëm i sinjaleve që kontrollon tani trafikun e trenave në dy tunelet që u përmbytën lejon për më pak trena në orë për të funksionuar për në dhe nga Penn Station.

“Dega e Long Biç (Long Beach) e Hekurudhës së Long Ajlënd (Long Island) nuk u kursye nga shkatërrimi që erdhi në Long Biç (Long Beach) dhe në komunitetet përreth nga Sendi (Sandy),” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Përgëzoj përpjekjet intensive të bëra nga LIRR për të pastruar, riparuar dhe zëvendësuar elementët përbërës të rëndësishëm në nënstacionet elektrike dhe pajisjet e sinjaleve të

dëmtuara nga përmbytja për të rivendosur lidhjen jetësore të transportit që siguron hekurudha ndërsa këto komunitete të goditura rëndë fillojnë të rindërtohen.”

“Rivendosja e shërbimit të trenit elektrik në Long Biç (Long Beach) ka qënë në krye të listës së përparësive të LIRR-t,” tha Presidentja e LIRR-t Helena E. Uilliams. “E kuptojmë rëndësinë e shërbimit të rregullt të trenit ndërsa përpjekja e rindërtimit vazhdon në komunitetin e Long Biç (Long Beach) dhe komunitetet e tjera të goditura rëndë përgjatë gjithë degës së Long Biç (Long Beach). Nënstacionet tona, që sigurojnë energjinë për të përdorur trenat, nuk i shpëtuan zemërimit të Sendit (Sandy), por ekipet tona kanë punuar pa u lodhur për të rikthyer energjinë, për të pastruar dhe rehabilituar çelësat dhe sinjalet, në mënyrë që të mund të rifillojmë shërbimin. E dimë se udhëtarët varen nga LIRR për të shkuar dhe ardhur në punë dhe për të mbërritur në NYC. Jemi shumë të kënaqur që jemi në gjendje të rivendosim shërbimin.”

Punonjësit e LIRR-t kanë punuar ditë e natë pas Sendit (Sandy) duke riparuar nënstacionet elektrike dhe pajisjet e rëndësishme të sinjaleve në Degën e Long Biç (Long Beach). Tre nga katër nënstacionet përgjatë degës së Long Biç (Long Beach) janë rikthyer tani në shërbim, përfshirë një në kantierin e LIRR në Long Biç (Long Beach) që gjithashtu pësoi dëm nga përmbytja dhe nga vërshimi i ujrave të zeza të papërpunuara nga një uzinë e trajtimit të ujrave të zeza aty pranë. Puna e riparimit vazhdon në nënstacionin Osheansajd (Oceanside).

Në Degën e Long Biç (Long Beach), rreth 1,000 elementë përbërës të sinjaleve elektrike u zëvendësuan, u riparuan ose u pastruan ndërsa punonjësit e sinjaleve të LIRR punuan në 21 vende të ndryshme të instrumentave të sinjaleve. Puna e tyre, përfshiu pjesërisht riparimin/zëvendësimin ose pastrimin e mbi 150 transformatorëve, 350 releve dhe 30 lidhjeve të ndërprerjes, si dhe qindra element të tjerë përbërës të sinjaleve. Ekipet e punës tashmë kanë riparuar ose zëvendësuar mbi 100 lidhje të tensionit të lartë (kabllo ushqyese për t’u dhënë energji nënstacioneve dhe shinës së tretë) në kantier dhe në degë.

Uji i kripur dëmtoi nënstacionet prej 3 megavati ku çelësat, ndërprerësit e qarkut, reletë dhe pjesët e tjera të rëndësishme të nënstacionit u pastruan, u riparuan ose u zëvendësuan. (Nënstacioni prej 3 megavat, që siguron 750 volt të korrentit të rrymës së drejtpërdrejtë për shinën e tretë për të përdorur trenat e LIRR-t, është i barasvlefshëm me energjinë për rreth 200 shtëpi.) Puna tjetër e riparimit do të vazhdojë në degë dhe LIIR gjithashtu do të shqyrtojë mënyra për të mbrojtur pajisjet e energjisë, të sinjaleve dhe të çelësave nga lloji i përmbytjes ekstreme të shkaktuar nga Sendi (Sandy).

Tarifat normale të fundjavës, jashtë orarit të pikut do të mblidhen në Degën e Long Biç (Long Beach) të dielën dhe tarifa të rregullta do të kërkohen të hënën. Megjithatë, udhëtarët e Long Biç (Long Beach) me një abone mujore të nëntorit që mund të jenë zhvendosur nga stuhia ende do të jenë në gjendje të përdorin abonenë mujore të tyre në të gjitha degët e tjera të LIRR-t deri më 1 dhjetor.

Shërbimi i rregullt i trenit gjatë fundjavës dhe shtesë gjatë fundjavës për festat

Përveç kthimit në shërbimin elektrik normal gjatë fundjavës, LIRR gjithashtu është duke shtuar shërbimin tjetër gjatë fundjavës për festat në Degën e Long Biç (Long Beach) për t'a bërë udhëtimin për në dhe nga Qyteti i Nju Jorkut më të rehatshëm për blerje, shkuarje për të ngrënë darka dhe për argëtim.

Tetë trena të tjerë janë duke iu shtuar grafikut të fundjaves – katër trena drejt perëndimit ndërmjet orës 9 në mëngjes dhe 1 pasdite dhe katër trena drejt lindjes ndërmjet orës 4 pasdite dhe 8 të mbrëmjes. Me këta trena shtesë, LIRR do të sigurojë shërbim çdo gjysmë ore gjatë kësaj periudhë të udhëtimit gjatë festave. Shërbimi shtesë gjatë fundjavës për festat do të ofrohet në fundjavë deri në fund të vitit.

Shërbimi i trenit gjatë ditëve të javës
Për shkak të pakësimit të kapacitetit në dy tunelet e Lumit Lindor të Amtrak-ut, katër trena të orës së pikut të mëngjesit dhe katër trena të ores së pikut të mbrëmjes në Degën e Long Biç (Long Beach) do të anullohen siç jepet me hollësi më poshtë:

<u>Trenat e pikut të mëngjesit të anulluar në Degën e Long Biç (Long Beach):</u>

(Katër trena të anulluar)

- Treni në 6:54 të mëngjesit nga Long Biç (Long Beach), që pritet në Atlantic Terminal në 7:49 të mëngjesit, është anulluar. Udhëtarët do të përdorin trenin e 7:04 të mëngjesit nga Long Biç (Long Beach) që pritet në Penn Station në 7:57 të mëngjesit. Udhëtarët për në Atlantic Terminal duhet të transferohen në Xhamejka (Jamaica).

- Treni në 7:23 të mëngjesit nga Long Biç (Long Beach), që pritet në Penn Station në 8:22 të mëngjesit, është anulluar. Udhëtarët do të përdorin trenin e 7:39 të mëngjesit nga Long Biç (Long Beach) që pritet në Penn Station në 8:32 të mëngjesit.

- Treni në 7:56 të mëngjesit nga Long Biç (Long Beach), që pritet në Atlantic Terminal në 8:51 të mëngjesit, është anulluar. Udhëtarët do të përdorin trenin e 8:03 të mëngjesit nga Long Biç (Long Beach) që pritet në Penn Station në 8:54 të mëngjesit. Udhëtarët për në Atlantic Terminal duhet të transferohen në Xhamejka (Jamaica).

- Treni në 8:08 të mëngjesit nga Long Biç (Long Beach), që pritet në Penn Station në 9:02 të mëngjesit, është anulluar. Udhëtarët do të përdorin trenin e 8:38 të mëngjesit nga Long Biç (Long Beach) që pritet në Atlantic Terminal në 9:26 të mëngjesit. Udhëtarët për në Penn Station duhet të transferohen në Xhamejka (Jamaica).

<u>Trenat e pikut të pasdites të anulluar në Degën e Long Biç (Long Beach):</u>
(Katër trena të anulluar)

- Treni në 4:40 të pasdites nga Penn Station, që pritet në Long Biç (Long Beach) në 5:37 të pasdites, është anulluar. Udhëtarët do të përdorin trenin e 5:00 të pasdites nga Penn Station, që pritet në Long Biç (Long Beach) në 5:55 të pasdites.

- Treni në 5:23 të pasdites nga Penn Station, që pritet në Long Biç (Long Beach) në 6:18 të pasdites, është anulluar. Udhëtarët do të përdorin trenin e 5:20 të pasdites nga Penn Station, që pritet në Long Biç (Long Beach) në 6:11 të pasdites.

- Treni në 7:33 të mbrëmjes nga Penn Station, që pritet në Long Biç (Long Beach) në 8:26 të pasdites, është anulluar. Udhëtarët do të përdorin trenin e 8:12 të mbrëmjes nga Atlantic Terminal, që pritet në Long Biç (Long Beach) në 9:03 të mbrëmjes. Udhëtarët në Penn Station duhet të përdorin trenin e 8:08 të mbrëmjes ngë Penn Station në Babilon (Babylon) dhe të transferohen në Xhamejka (Jamaica) për trenin e Long Biç (Long Beach).

- Treni në 8:30 të mbrëmjes nga Penn Station, që pritet në Long Biç (Long Beach) në 9:22 të pasdites, është anulluar. Udhëtarët do të përdorin trenin e 9:00 të mbrëmjes nga Atlantic Terminal, që pritet në Long Biç (Long Beach) në 9:50 të mbrëmjes. Udhëtarët në Penn Station duhet të përdorin trenin e 8:42 të mbrëmjes ngë Penn Station në Hantingtën (Huntington) dhe të transferohen në Xhamejka (Jamaica) për trenin e Long Biç (Long Beach).

Shërbimi gjatë ditëve të javës pothuajse normal tani në të gjitha degët

Me shtimin e shërbimit elektrik në Degën e Long Biç (Long Beach), LIRR tani është duke funksionuar me një grafik pothuajse normal gjatë ditëve të javës dhe të rregullt gjatë fundjavës në të gjitha degët anembanë sistemit.

Duke filluar të hënën 26 nëntor, me shtimin e shërbimit elektrik të Long Biç (Long Beach), grafiku gjatë ditëve të javës i LIRR-t përfaqëson mesatarisht 80 përqind të kapacitetit të rregullt gjatë orëve të pikut të LIRR-t. Njëzet e gjashtë nga 143 trenat e orëve të pikut të mëngjesit do të anullohen ose devijohen në një stacion tjetër. Në orët e pikut të mbrëmjes, nga 127 trenat që përdor LIRR, 27 do të anullohen. Në përgjithësi, gjatë gjithë ditës, ndryshimet sigurojnë rreth 92 përqind të kapacitetit normal të shërbimit për ditët e javës.

Amtrak është duke vazhduar punën e tij për të bërë riparime të përherëshme në sistemin e sinjaleve në dy prej tuneleve të tij të Lumit Lindor të përmbytur gjatë super stuhisë. Riparimet e përkohëshme, që lejuan që tunelet të rihapeshin më parë këtë muaj, pakësojnë numrin e trenave që mund të udhëtojnë nëpërmjet tuneleve. Amtrak vlerëson se riparimi i sistemit të sinjaleve të dëmtuar nga uji i kripur nuk pritet të përfundojë deri në fund të vitit. LIRR ka qënë në kontakt të afërt me Amtrak për planin dhe

përpjekjet e riparimit.

Si rezultat i kapacitetit të pakësuar të tunelit, grafiku i ditëve të javës i LIRR-t vazhdon të përfshijë trena të anulluar dhe/ose të devijuar gjatë orëve të pikut të mëngjesit dhe të mbrëmjes deri në fund të vitit.

Udhëtarët e LIRR duhet të presin që trenat të jenë plot
Meqënse shërbimi vazhdon të jetë i kufizuar gjatë ditëve të javës, kohët e pritjes do të jenë më të gjata dhe trenat do të jenë të mbushur më plot. Udhëtarëve u këshillohet që të lejojnë kohë shtesë për udhëtimin dhe të presin vonesa 10-15 minuta. Gjatë orës së pikut të mbrëmjes, udhëtarët duhet të presin kushte të mbushura plot në Penn Station. Udhëtarët këshillohen të rregullojnë orët e punës dhe të udhëtojnë në orët jo të pikut, nëse është e mundur, për të ndihmuar në pakësimin e turmave gjatë periudhave të pikut.

Për më shumë informacion
Udhëtarët duhet të vëzhgojnë njoftimet e lajmeve, faqen në internet të MTA-së, www.mta.info, dhe të rregjistrohen për E-Alerts falas për azhornime të shërbimit të LIRR. Udhëtarët gjithashtu mund të kontaktojnë Qendrën e Informacionit për Udhëtim të LIIR duke telefonuar në 511, Linjën e Informacionit për Udhëtim të Shtetit të Nju Jorkut dhe të thonë: Long Ajlënd Reill Roud. Nëse jeni shurdh ose keni vështirësi të dëgjimit, përdorni siguruesin tuaj të preferuar të shërbimit me rele për relenë falas 711 për të kontaktuar me LIRR në 511.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

(Shihini skedarin e bashkëngjitur: Anullimet dhe devijimet e LIRR-t.pdf)